

12/b Organizimi dhe struktura 2 pikë . Duhet të kihet parasysh:

- Pjesët përbërëse(hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Kronologjia(rend të mendimit dhe ideve, të shembujve që jep).
- Logjika(të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë).
- Kalimet e kuptimshme (nga fjala te objekti).

1 pikë. Kur respekton vetëm strukturën e krijimit

0 pikë. Kur struktura nuk të jep asnjë kuptim.

12/c Stili dhe origjinaliteti . 2 pikë. Duhet të kihet parasysh:

- Shprehjet origjinale (figuracioni, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
- Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues. (me rrjedhshmëri , të ketë efekt)
- I qartë.
- Jo imitues,(të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij.

1 pikë. Kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.

0 pikë. Kur nuk thotë asgjë, ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

12/d Saktësia gjuhësore(sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë Duhet të kihet parasysh:

- Trajta e duhur e fjalëve.
- Fjali të sakta.
- Shenjat e pikësimit.
- Shkronja e madhe.

1 pikë. Kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar

0 pikë. Kur gabimet e shumta deformojnë ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

Pjesa e dytë Evgjëni Grande

Pyetja 13 A 1 pikë

Pyetja 14 D 1 pikë

Pyetja 15 C 1 pikë

Pyetja 16 A 1 pikë

Pyetja 17 B 1 pikë

Pyetja 18 C 1 pikë

Pyetja 19 C 1 pikë

Pyetja 20 3 pikë

Shtëpia e Evgjenisë nuk dukej e përshtatshme për të pritur mikun;

Detajet: e zhveshur, pa shije pa elegancë.

2 pikë Kur cilëson si ishte shtëpia dhe jep vetëm një detaj, ose jep vetëm dy detajet pa koment.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm detajet, ose vetëm koment.

0 pikë. Nëse nxënësi nuk jep asnjërin nga përgjigjet.

Pyetja 21 4 pikë pikë

Në fjalitë e ndërtuara të dalin këto tipare:

21/a. Hijeshia dhe femëria.

21/b. Ndjenja e dashurisë, butësia, lumturia.

21/c. Ndrojtja, turpi.

21/d. Padjallëzia, sinqeriteti, mirësia.

3 pikë Kur jep tre fjali të sakta.

2 pikë Kur jep dy fjali të sakta.

1 pikë Kur jep një fjali të saktë.

0 pikë Kur nuk jep asnjërën.

Pyetja 22 3 pikë

22/a Proliksiteti dhe përshkrimi.

22/b Tipizimi dhe detajimi.

22/c Realizmi ose vërtetësia.

2 pikë Kur jep dy nga tiparet.

0 pikë Kur jep vetëm një nga tiparet.

0 pikë Kur nuk jep asnjë nga tiparet.

Pyetja 23 3 pikë

23/a Do më shikojë, do më marrë në konsideratë, etj

23/b Vlerëson veten, mendjemadh, bie në sy etj.

23/c I shtohet inati, mllefi, etj

2 pikë. Kur shpjegon dy nga shprehjet.

1 pikë. Kur shpjegon një të shprehjet.

0 pikë. Kur nuk shpjegon asnjërën.

Pyetja 24 1 pikë

Janë emra abstraktë .

0 pikë. Kur nuk jep këtë përgjigje.

Pyetja 25 3 pikë

- Shprehja është marrë nga fragmenti dhe ka kuptimin: Që sytë të njeriut, shprehin atë që të ndjen zemra. Gjithçka që ndjen pasqyrohet në fytyrë.

- Tiparet që i jep njeriut ky pasqyrim janë: dëlirësia, sinqeriteti, kuptueshmëria, thjeshtësia (referuar edhe Evgjenisë).

- Nxënësi mund të shkruajë gjatë komentit edhe shprehje të përafërta nga kuptimi ose mund të marrë shembuj për t'iu referuar kuptimit.

2 pikë. Kur nxënësi jep vetëm një kuptim për thënien dhe një argument pse ai e kupton ashtu, por të formuluar mirë.

1 pikë. Jep dobët kuptimin mbi shprehjen pa ilustrim dhe pa argument.

0 pikë. Kur shpjegimi është i paqartë dhe i palexueshëm.